



**VENDIM**

**Nr. 104, Datë 23.06.2016**

**MBI**

**PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE  
REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË  
PËRKOHESISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITËSHME  
SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE NR.49, DATË  
21.10.2004, DHE NR. 146, DATË 24.12.2013**

Në mbështetje të neneve 16; 76 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 44/2015; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive teknike të ERE, në lidhje me miratimin e “Mbi Përcaktimin e Metodologjisë së Vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritëshme si dhe mbi shfuqizimin e Vendimeve të ERE nr.49, date 21.10.2004, dhe nr. 146, date 24.12.2013”,

**Konstatoi:**

- Me shkresën e OSHEE sh.a. nr. 10473 Prot date 02.06.2016 është bërë me dije se deri në datë 30 Qershor, OSHEE sh.a. do të realizojë paisjen me matësa të të gjithë klientëve.
- Në nenin 76 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” është parashikuar “Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritëshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.
- Me shfuqizimin e vendimeve të ERE nr. 49, date 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matësa jashtë kushtit teknik” dhe nr.146 datë 24.12.2013 “Mbi kërkesën e CEZ shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe permbushen parashikimet e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

### **Vendosi:**

1. Shfuqizimin e vendimeve të ERE nr. 49, date 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matësa jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013 “*Mbi kërkesën e CEZ shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfë*” dhe të cdo vendimi që bie në kundërshtim me këtë vendim.
2. Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohesisht të padisponueshme ose të paarrtëshme për një periudhë me të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar apo jashtë kushtit teknik) e bën faturimin duke u bazuar në mesataren mujore të faturimit me matje të 3 muajve respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi me 1 korrik 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

**VENDIMIN**

*Nr. 104, Datë 23.06.2016*

**MBI  
PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE  
REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË  
PËRKOHESISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITËSHME  
SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE NR.49, DATË  
21.10.2004, DHE NR. 146, DATË 24.12.2013**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____